

## Binak (Cenë) Zajaj

(19.03.1967, egjiptian nga Novosella e Ulët/Donje Novo Selo, komuna e Gjakovës/Đakovica, bari, tre fëmijë)

Binaku ishte bari. Nga fundi i muajit qershor të vitit 1998, ai hoqi dorë nga çuarja e bagëtisë në kullotë, sepse në pyjet përreth fshatit ishin paraqitur forcat serbe. Në datën **8.07.1998**, herët në mëngjes, nga ora 2:00, ushtarët në uniformat maskuese të ngjyrës së gjelbër e kanë zgjuar nga gjumi familjen Zajaj dhe i kanë urdhëruar Binakut që të nisej me ta [**Novosellë e Ulet/Donje Novo Selo**]. Nënë Cymes i thanë se Binakun do ta kthenin ditën tjetër. Ishte kjo hera e fundit që familjarët e shihnin të gjallë. Për fatin e Binakut nuk dihej asgjë për vite me radhë. Vetëm më 11.02.2005, familja Zajaj është njoftuar se trupi i Binakut ishte gjetur në muajin qershor të vitit 2004, në varrezat e fshatit Bardhaniq/Bardonić. Atë e kishin identifikuar në bazë të analizës së ADN-së. Familjarët e kanë varrosur Binakun në varrezat e Gjakovës/Đakovica.

**Burimet:** deklarata Z.K. FDH-35550; OMPF, *Regjistri i konsoliduar...*, FDH-32367.

## Fatmir (Rexhep) Hasandoçi

(14.08.1978, shqiptar nga Bujani, komuna e Tropojës [Shqipëri], pjesëtar i UÇK-së)

Fatmiri u bë pjesëtar i UÇK-së më 2.06.1998. godine. U emërua komandant i njësitit në fshatin **Smolicë/Smonica**. Në datën **8.07.1998**, përderisa i trajnonte disa ushtarë të UÇK-së, në afërsi të tij ka rënë dhe ka eksploduar predha e shkrepuar nga një tank serb. Fatmiri ka gjetur vdekjen në vend. Një ditë më vonë, u varros në varrezat e Smolicës/Smonica.

**Burimet:** H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596; SHFDUÇK, *Feniksët...10*, 79-80; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

## Imer (Sadri) Osmanaj

(20.01.1958, shqiptar nga fshati Prekallë/Prekale, komuna e Istogut/Istok, teknik, tre fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Imeri ka shkuar me disa miq në Junik më 8.07.1998. Atje shkuan për të marr dikë si

udhërrëfyes, që do t'i çonte matanë kufirit me Shqipërinë për një ngarkesë të re armatimesh. Në datën **9.07.1998**, u nisën nga Juniku/Junik në drejtim të kufirit. Dy ditë më vonë, familjen e kanë njoftuar se Imeri me bashkëluftëtarë kanë rënë në pritë të forcave serbe te vendi i quajtur *Rrasa e Zogut/Ptičiji kamen*, në rajonin e **Koshares/Košare**, dhe se ai pësoi më këtë rast. Trupi i tij ka mbetur në vendin e ngjarjes. Familjarët e Imerit kanë bërë përpjekje vite me radhë, madje edhe pas përfundimit të luftës, për të gjetur trupin e tij. Më në fund, më 16.05.2005, përfaqësuesit e KNKK-së e kanë njoftuar familjen se mbetjet mortore të Imerit janë zbuluar në fund të muajit gusht të vitit 2003 dhe se, nga ajo ditë, ato gjendeshin në morgun e Rahovecit/Orahovac. Familjarët i kanë tërhequr mbetjet mortore të Imerit më 19.05.2005. Po atë ditë, i kanë varrosur në varrezat e fshatit.

**Burimet:** deklarata S.O, FDH-16310; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

## Isa (Peshk) Malaj

(1942, shqiptar nga fshati Peraj, komuna e Hasit [Shqipëri])

## Halim (Zenun) Bardhoshi

(15.05.1947, shqiptar nga fshati Peraj, komuna e Hasit [Shqipëri])

Isa dhe Halimi jetonin në fshatin Peraj në Shqipëri, në zonën kufitare me Kosovën. Kur filluan konfliktet e armatosura në Kosovë, ata filluan t'i bartnin armatime me kuaj samari për UÇK-në. Një orë pas mesnate, më **9.07.1998**, Isa, Halimi dhe një person i tretë, në bazë të marrëveshjes paraprake me UÇK-në, i kanë sjellë armatimet në vendin e quajtur *Livadhet e Gjonit/Đonijeve livade* [**Zhub/Žub**] dhe, më pas, u nisën për në fshatin e tyre. Por, pas pak, forcat serbe kanë shtënë mbi ta. Isa dhe Halimi u qëlluan dhe gjetën vdekjen menjëherë. Familjarët i kanë varrosur viktimat në fund të korrikut të vitit 1998, në fshatin e tyre të lindjes, në Peraj.

**Burimet:** deklarata H.K, FDH-29052; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), D 300.69, FDH-30561; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832.